



(MOS)PAVARESIA NGA IMPORTI

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2023



AUTOR

EDMORELA MYFTARAJ

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Përmbajtje

1.Hyrje	3
2. Investimi në importin e energjisë.....	3
3.Trendet e importit, Shqipëria në krahasim me vendet fqinje	5
4.Reflektim në çmim	7
5.Nismat për diversifikim të energjisë.....	8
6. Gjetjet kryesore.....	11
7. Rekomandime.....	11

1. Hyrje

Shqipëria cilësohet si një vend pothuajse tërësisht i varur nga burimet hidrike për furnizimin me energji elektrike.¹

Ndërkohë që cilësohet si një metodë shumë e mirë për dekarbonizimin e sektorit energjistik, shpesh vihet në dukje hallka e dobët e këtij zinxhiri prodhues pasi është drejtëpërdrejtë i varur nga ndryshimet klimaterike, gjë që vihet re në vitet e fundit.

Bazuar në agjendat e gjelbra, palë e marrëveshjeve me synime të njëjta në të cilat pjesë është dhe vendi ynë, fokusi po ripozicionohet në panelet fotovoltaike. Në këtë këndvështrim, janë kryer investime por me ndikime thuajse jo të dukshme në industrinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Duke konsideruar raportin e burimeve të rinovueshme me nivelin e investimeve dedikuar diversifikimit të energjisë, pritshmëritë e vendosura dhe nga BE që suporton në mënyrë konsistente me fonde, do të duhet të ishin më të arrira si rezultat i hapësirave që ekzistojnë për shfrytëzimin e burimeve solare dhe eolike.

Në këtë drejtim, duket se e vetmja zgjidhje e ndjekur nga instancat përkatëse ka qenë blerja e vazhdueshme e energjisë elektrike duke e kthyer importin në një sektor ku investohet në masë.

2. Investimi në importin e energjisë

Sipas burimeve, Shqipëria ka shpenzuar një shifër prej 500 milionë eurosh për importin e energjisë vitin e kaluar². Në raport me buxhetin e shtetit të vitit 2022, sipas nenit 1 të aktit normativ Nr. 19, datë 29.12.2022 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.115/2021, "PËR BUXHETIN E VITIT 2022", TË NDRYSHUAR, të ardhurat kanë qenë në shifrën 583 315 milionë

¹ <https://biepag.eu/wp-content/uploads/2023/05/Energy-in-the-western-Balkans-2.pdf>

² <https://politiko.al/e-tjera/birn-shqiperia-shpenzoi-500-milione-euro-per-import-energjie-vitin-e-kal-i479339>

lekë, ndërkohë që blerja e energjisë nga Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë ka kushtuar 500 milionë euro për mbulimin e nevojave të shtetit.

Të dhënat e detajuara të publikuara nga Enti Rregullator i Energjisë tregojnë se KESH importoi përgjatë të gjithë vitit me përjashtim të dhjetorit ndërsa eksportoi një sasi të vogël energjie në prill si dhe në nëntor e dhjetor.

Çmimi mesatar i blerjes së energjisë ishte 305 euro për Mwh, çmimi më i lartë i shënuar ndonjëherë në histori, ndërsa çmimi i shitjes së energjisë në kushtet kur rreshjet ishin të shumta, ishte 174 euro për Mwh.

BE i ka akorduar një buxhet prej 72 milion euro qeverisë shqiptare me qëllim përballimin e pasojave socio ekonomike të krizës energjitike.³ Në qendër të shfrytëzimit të këtij fondi qëndron subvencionimi i cmimeve të energjisë elektrike (mundësisht nën pragun mujor të konsumit) për familjet dhe ndërmarrjet e vogla ose të mesme për të krijuar norma të ngjashme si përpara krizës. Pjesë e masave të parashikuara janë diversifikimi i burimeve të energjisë përmes burimeve solare dhe erës. Në bazë të implementimit të këtyre masave, në 2024 parashikohet dhe marrja e një fondi tjetër prej 8 milion eurosh. Në këto kushte, Shqipëria ka një buxhet të konsiderueshëm për të bërë ndryshime relevante në fushën energjitike.

Duke konsideruar faktin që këto fonde janë të pakthyeshme, përkthehen në investime direkte. BE sugjeron fokusin tek investimet ekzistuese sic janë hidrocentrali i Fierzës dhe Vau i Dejës. Synohet që përmes këtyre fondeve të rivitalizohet hidrocentrali i Fierzës i cili ka një prodhim mesatar prej 1300 Gwh.⁴

Nga ana tjetër, projekti i krijimit të një impianti fotovoltaik lundruar mbi HEC Vau i Dejës (mbi rezervuarin e këtij hidrocentrali) është një projekt që synohet të finalizohet për të përqëndruar investimet në fushën e energjisë së rinovueshme. Në bazë të statistikave, panelet fotovoltaike kanë një performancë të ulët dhe nuk impaktojnë prodhimin e energjisë. Bilanci i energjisë elektrike për tremujorin e dytë të vitit 2023⁵

³ https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/eu-transfers-eur-72-million-albania-part-energy-support-package_en?s=214

⁴ <https://www.kesh.al/asset/hec-fierze/>

⁵ <https://www.instat.gov.al/media/12408/bilanci-i-energjis%C3%AB-elektrike-tr-ii-2023.pdf>

tregon se prodhimi prej impianteve fotovoltaike në Shqipëri prek shifrën 26161 Mwh.Në krahasim me prodhimin total, është një shifër e vogël dhe thuhet se është irrelevante por që ka pësuar ndryshime në rritje që nga viti 2021.

Shqipëria është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që ka ritur kapacitetet prodhuese energjitike duke u fokusuar vetëm tek shtimi i prodhuesve hidroenergjitike duke e kthyer sektorin energjistik në një sektor të ndikuar drejtëpërdrejtë nga ndryshimet klimaterike .Deri në vitin 2017, nuk ka pasur nisma për të fuqizuar burimet e rinovueshme alternative si era apo dielli. Deri në fund të vitit 2021, burimet e paneleve fotovoltaike shënonin një prodhim prej 23 Mwh.⁶

3.Trendet e importit, Shqipëria në krahasim me vendet fqinje

Statistikat e Institutit të Energjisë, theksojnë si trend global në rritje sidomos për vitin 2023, shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike.Këtë vit,energjia e përfituar nga burimet diellore dhe të erës, përbëjnë 7.5% të konsumit primar të energjisë, referuar vendit tonë.⁷

Kriza e energjisë në Europë, si rezultat i luftës në Ukrainë, shkaktoi një ngërc në situatën e shteteve europiane për sigurimin e energjisë.Një nga këto vende ishte dhe Kosova e cila e siguron energjinë deri në 90% përmes burimeve natyrore të qymyrit.Në rastin e Kosovës, vetëm një pjesë e vogël e energjisë sigurohet nga burime hidrike,eolike dhe diellore.Gjithsesi Fondi Ndërkombëtar Monetar shprehet se situata e importit të elektricitetit ka qenë nën kontroll dhe ka pasur madje ulje në 35% të importit për elektricitet.⁸ Tregjet e energjisë nuk janë të dizajnuara për të përballuar në mënyrë efikase burimet si burimet e rinovueshme të cilat kushtojnë shumë për t'u ndërtuar, por shumë më

⁶ [https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/energy-sector-in-albania#:~:text=Albania%20is%20the%20only%20country,ones%20\(see%20Regulator's%20report\)](https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/energy-sector-in-albania#:~:text=Albania%20is%20the%20only%20country,ones%20(see%20Regulator's%20report))

⁷ <https://www.forbes.com/sites/irrapier/2023/08/06/global-energy-trends-insights-from-the-2023-statistical-review-of-world-energy/?sh=4f1f91ea3502>

⁸ <https://www.imf.org/en/Publications/selected-issues-papers/Issues/2023/04/20/Kosovos-Electricity-Sector-Challenges-and-Opportunities-Republic-of-Kosovo-532631#:~:text=Kosovo's%20Electricity%20Sector%20Challenges%20and%20Opportunities%3A%20Republic%20of%20Kosovo,-Author%2FEditor%3A&text=Summary%3A,Kosovo's%20energy%20sector%20and%20budget>

pak se karburantet fosile për t'u përdorur. Ky përfundim shpjegon dhe rastin e Kosovës.

Për sa i përket Shqipërisë, e cila importon energji nga Kosova dhe duke marrë parasysh avantazhet e saj gjeografike, del në pah një kapacitet prodhimi i vlerësuar deri në 18 Twh. Megjithatë, shfrytëzimi aktual arrin vetëm një të tretën e këtij kapaciteti potencial, duke nënkuptuar mundësi të pashfrytëzuara për rritjen e prodhimit të energjisë përmes burimeve vendase. Ekziston një hendek mosbalance për sa i përket shfrytëzimit të burimeve ndërkohë që vende si Kosova me burime më të kufizuara, janë duke bërë një punë më të mirë në uljen e importit në nivel kombëtar.

Importi si instrument për sigurimin e energjisë elektrike të nevojshme, mund të shihet dhe në anën tjetër të medaljes. Në vitin 2021, Britania e Madhe ka importuar sasi të mëdha të energjisë pavarësisht fokusit të vazhdueshëm në politikat për diversifikim dhe fondeve të mëdha të investuara. Në këtë sferë, importi kushton më pak se vetë prodhimi i energjisë elektrike.

Referuar rastit të mësipërm, ndërmarrja e politikave nga sektori publik është esencial por është faktor me peshë edhe sektori privat. Legjislacioni shqiptar ofron lehtësi për investimet në këtë fushë dhe MIE asiston investitorët në çdo procedurë përfshirë dhënien e lejeve etj. Investitorët e huaj në sektorin e energjisë mund të përfitojnë edhe një mbrojtje të veçantë ligjore, e cila ofrohet sipas ligjit nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë" përfshirë investimet strategjike në fushën e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.⁹

⁹<https://www.inhouselawyer.co.uk/legal-briefing/why-albania-should-be-your-destination-to-invest-in-the-energy-sector/>

4. Reflektim në çmim

Mbështetja në energjinë e importuar për të përmbushur kërkesat kombëtare e ekspozon një vend ndaj paqëndrueshmërisë së skenarëve financiarë dhe politikë. Shqipëria, e cila kryesisht importon energji elektrike nga vendet fqinje si Greqia dhe Kosova, nuk ka qenë immune ndaj krizës energjetike që ka ndikuar në të gjithë peizazhin evropian. Rritja e çmimeve të energjisë elektrike, që i atribuohet konfliktit në Ukrainë, ka bërë jehonë në të gjithë Shqipërinë, duke përforcuar sfidat e plotësimit të nevojave për energji.

Sipas OpenData, bazuar në të dhënat nga Rezultatet e Tenderave për shitjen e energjisë nga KESH, energjia elektrike është shitur nën cmimet mesatare të përcaktuara nga cmimi i bursës në HUPX. Në periudhën kohore Janar-Shkurt 2023, KESH nuk ka optimizuar situatën dhe ka përfituar shuma më të vogla nga transaksionet.¹⁰ Për muajin Shkurt 2023, energjia elektrike është shitur me cmim mesatar 95.79 euro/Mwh ndërsa në muajin Maj 2023, me cmimin 62.28 euro/Mwh. Ndërkohë, energjia elektrike sipas tenderave të hapura nga KESH është blerë me cmime disa herë më të larta, ku cmimi më i lartë ka arritur në 305.47 Euro/Mwh.

Diferenca e madhe në cmimin e energjisë së blerë, pra të importuar, qëndron tek afatet e shkurtra të tenderimit. Në datën 26 Tetor 2023, KESH ka publikuar një kërkesë për ofertë për blerje të energjisë elektrike për një periudhë shumë të afërt 1-30 Nëntor. Afërsia me afatin e blerjes ndikon tek cmimi i blerjes në raport të drejtpërdrejtë. Duke pasur afate të shkurtra, çënohet konkurenca dhe rakordohet cmim më i lartë sec do rakordohej në kushte optimale duke u bazuar dhe tek sistemi i bursës.

Mungesa e rezervave të energjisë elektrike, si rezultat i shitjes së saj (madje me cmime më të ulëta se ato referuar bursës hungareze), si edhe për shkak të hapjes së portave të digave me arritjen e kuotave maksimale të ujit, siguron hendek në sasi të nevojshme për përdorim duke lënë si opsion importin e energjisë.

¹⁰ <https://ndiqparate.al/?p=19773>

Zhvendosja drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë jo vetëm që zvogëlon varësinë nga energjia elektrike e importuar, por gjithashtu siguron një përmbushje të plotë të masave të nevojshme të konsumit. Gjetjet e fundit të INSTAT zbuluan një rënie të dukshme të konsumit të energjisë gjatë tremujorit të dytë të 2023, duke shënuar një rënie prej 3.5% nga 1.533 Gwh në 2022 në 1.479 Gwh. Këto shifra, kur krahasohen me të dhënat e bilancit të energjisë nga INSTAT, ilustrjnë konsumin që përbën 56% të prodhimit neto dhe importeve të energjisë.

Vështrimet e Eurostat-it për tremujorin e parë të vitit 2023 hedhin dritë mbi çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, duke e vendosur atë në 0.10 euro për këh, një normë relativisht më e lartë brenda rajonit në kontrast me vendet si Kosova, Serbia dhe Bosnja.

Tenderi më i fundit i KESH-it për prokurimin e energjisë elektrike gjatë nëntorit 2023 siguroi një blerje të konsiderueshme prej 72,000 Mwh. Çmimi i ponderuar i llogaritur ishte 8,953,200 milionë euro, duke pasqyruar një konsistencë në sasinë e importit nga viti i kaluar. Pavarësisht niveleve të qëndrueshme të importeve, vihet re një mungesë e dukshme e luhatjeve të çmimeve gjatë vitit, pavarësisht shifrave të reduktuara të konsumit. Pra ulja e konsumit nuk ka rezultuar në ulje të nevojës për të importuar, dhe as në ulje të cmimit.

5.Nismat për diversifikim të energjisë

Plani për tranzicionin drejt politikave të gjelbra dhe miqësore me mjedisin për Ballkanin Perëndimor synon riorientimin drejt përmirësimit të infrastrukturës dhe ndërmarrjen e reformave që stabilizojnë aspektin e furnizimit me energji në burime të tjera përveçse hidrike. Ka dy përfitime të drejtpërdrejta për Ballkanin Perëndimor në lidhje me axhendën e gjelbër të BE-së. Së pari, axhenda i paraqet rajonit një mundësi për të modernizuar sektorin e tij energjetik përmes IHD-ve dhe asistencës së BE-së. Modernizimi forcon sigurinë e furnizimit për shkak të bollëkut të burimeve të rinovueshme dhe, potencialisht, ul çmimet e energjisë elektrike. Tranzicioni i gjelbër premtan gjithashtu përfitime mjedisore, duke përfshirë ajër më të pastër.¹¹

¹¹ <https://carnegieeurope.eu/2023/10/09/green-transition-and-ēestern-balkans-pub-90730#:~:text=The%20Energy%20Community%20has%20set,metric%20tons%20of%20carbon%20dioxide>

Për sa i përket Shqipërisë, në drejtim të përafrimit dhe përqafimit të politikave europiane, "Plani i veprimit për integrim për vitin 2022-2025" cilëson me risk mesatar rubrikën e vonesave në propozimin, hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me acquis. MIE në këtë strategji sugjeron përafrimin e legjislacionit me afat gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.

Pavarësisht se Shqipëria ka firmosur Deklaratën e Sofies për Axhenden e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe synon dekarbonizimin deri në vitin 2050, sektori i prodhimit të energjisë përfshin TEC Vlorë që punon përmes gazit.¹² Sipas raportit të INSTAT për tremujorin e dytë të 2023, prodhimi i energjisë nga ky termocentral është 0. Përtej investimit, ky termocentral nuk kontribuon në plotësimin e nevojave për energji.

Në kuadër të politikave për diversifikimin e energjisë, Shqipëria ka burimet e duhura për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme (IRENA) vlerëson potencialin diellor dhe të erës të Shqipërisë në mbi shtatë gigavat: më shumë se trefishi i kapacitetit total gjenerues të vendit. Raporti IRENA pretendon se vendi mund të vendosë 600 Mwh energji nga era dhe dielli deri në vitin 2030.¹³

Sipas pritshmërive të Komunitetit të Energjisë, deri në vitin 2030 është vendosur si target që 31% e konsumit final bruto të energjisë duhet të vijë nga burime të rinovueshme. Në raportin e INSTAT mbi Bilancin e energjisë për tremujorin e dytë të 2023, prodhimi neto i energjisë është shumatore e prodhimit nga hidrocentralet dhe panelet fotovoltaike tërësisht. Në këtë drejtim, Shqipëria ka zhvillime pozitive. Gjithashtu është një ndër vendet e vetme në Ballkanin Perëndimor që nuk prodhon energji përmes qymyrit.

¹² <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/energy-sector-in-albania>

¹³ <https://balkanenergynews.com/irena-albania-cost-effective-solar-wind-potential-estimated-at-more-then-7-gw/>

Në lidhje me burimet eolike, vendi ynë ka premisa për prodhim në shifrat 2,000 Mwh.¹⁴ Në projektet e qeverisë shqiptare në drejtim të shfrytëzimit të këtij potenciali të konsiderueshëm planifikohet arritja e sigurimit të prodhimit të 5% të energjisë së nevojshme përmes burimeve eolike. Premisat në këtë sferë parashikojnë mundësinë për krijimin e 20 centraleve eolike. Përgjatë vitit 2023 qeveria shqiptare ka miratuar ndërtimin e 4 parqeve eolike por duhet theksuar se deri tani nuk ka pasur kurrë më parë shfrytëzim të këtij burimi.¹⁵

“Përtej kufijve – drejt një tregu të qëndrueshëm të qëndrueshëm energjie” është nisma e qeverisë shqiptare e cila gjatë një konference të vitit 2022 ku pjesëmarrës ishin dhe kompani lider në treg nga SHBA dhe BE, flitej për zbatimin e planit ambicioz të transformimit të Shqipërisë në eksportues neto të energjisë dhe kampione e Ballkanit për energjinë. Në këtë drejtim, nuk ka arritje aktuale.

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, importi bruto arriti vlerën 355 Gwh ndërsa eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 786 Gwh.

¹⁴ <https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Energy-FactSheet.pdf>

¹⁵ <https://scantv.al/qeveria-miraton-3-centrale-eolike-fuqia-e-instaluar-nga-3-më-shteti-do-marre-2-te-energji-se-prodhuar/>

6. Gjetjet kryesore

- Statistikat tregojnë ulje të konsumit të energjisë por jo ulje cmimi apo nivelit të importit të energjisë.
- Mungon efienca në investime pasi panelet fotovoltaike ekzistente nuk sigurojnë prodhim të mjaftueshëm.
- Importojmë energji nga vende që nuk kanë faktorë gjeografikë dhe klimaterikë të njëjtë si ne, zotërimi i këtyre burimeve rezulton i pamjaftueshëm për nevojat e shtetit.
- Prodhimi i energjisë së gjelbër është fokus i politikave si dhe kemi siguruar fonde dhe mbështetje ndërkombëtare të konsiderueshme për të parë rezultate eficiente.

7. Rekomandime

- Fokus në diversifikim të burimeve duke shmangur investimet që bien ndesh me synimet për dekarbonizim (termocentralet që sigurojnë 0 prodhim energjie).
- Mbështetje e sektorit privat përmes faturimit vjetor dhe lehtësive në implementimin e paneleve fotovoltaike si dhe tërheqja e investimeve në këtë fushë duke krijuar trajnime specifike në mënyrë që të ketë individë të specializuar për këtë industri në rritje, rritja e vëmendjes tek përfitimet e vendosjes së panelit fotovoltaiq që lidhet me sigurimin e energjisë elektrike për një kohë të gjatë, mbrojtje e mjedisit dhe rritje të vlerës së pronës.
- Nevojitet një fokus i veçantë për të rritur ndërlidhjet ndërmjet investitorëve/kompanive dhe ofruesve të arsimit/trajnitimit; rritje e mundësive për mësim të bazuar në punë në kompani; dhe përfshirje e trajnitimit të vendasve si pjesë e paketës së investimeve nga kompani të huaja.
- Alokim i koordinuar i fondeve europiane për të siguruar rritje reale në prodhimin vendas të energjisë duke shfrytëzuar erën dhe diellin. Bazuar dhe në rekomandimet e BE në raportin e publikuar në datë 8 Nëntor 2023, nuk janë adresuar sic duhet

sugjerimet e shprehura në raportin e një viti më parë për sa i përket sektorit energjitik. Vendoset theksi tek përditësimi i Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, progresi për sa i përket forcimit të linjave interkonjektuese me vendet fqinje dhe rritja e konsultimeve publike për sa i përket investimeve të reja.¹⁶

- Blerja e energjisë duhet të menaxhohet me eficiencë në termat e hapjes së kërkesave për oferta dhe mbylljes së tenderit në hapësira kohore që lejojnë të ofrohen disa oferta në mënyrë që cmimi i ponderuar të arrijë mesataret që paraqet dhe bursa HUPEX.

¹⁶ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al